



Prishtinë: 30.06.2009

Kodi i ZRRE-së: V_198_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_229_06_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_229_09_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 19.06.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit ismet Sadiku (shifra e konsumatorit DPR – 14580) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 16.04.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 02.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 13.03.2008 ekipet inspektuese të KEK-u kane vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të kontrollimit të pikës matëse (njehsorit elektrik), gjatë inspektimit (kontrollimit) të njehsorit elektrik ekipi zyrtare i KEK-ut kanë konstatuar se në anën e majtë të njehsorit elektrik është një vrimë nga ku mundë të pengohet matja e saktë e energjisë së konsumuar, dhe kanë kërkuar që ky njehsor duhet të dërgohet në laboratorin e kalibrimit për verifikim.
Provë: Procesverbali nr 068180 i datës 13.03.2008
- Me datë 15.04.2008 ekipet zyrtare të KEK-ut për ndërrimin e njehsorëve kanë hekur nga matja e konsumit të konsumatorit njehsorin me nr 10541104 dhe kanë vendosur njehsorin me nr 4692533.
Provë: Procesverbali nr 068656 dhe nr 004000 për ndërrimin e njehsorit të datës 15.04.2008

- Me datë 13.05.2008 Qendra e laboratorit te kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik me nr 10541104 dhe ka konstatuar se kapaku i epërm i njehsorit elektrik është i shpuar, përmes vrimës është penguar puna e disku si dhe disku i njehsorit është i gërvishtur.
Provë: Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 10/13 të datës 13.05.2008
- Me datë 14.06.2008 mbështetur në procesverbalin e laboratorit të kalibrimit ekipet zyrtare te KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të përshkrimit të parametrave teknik për faturim të rikthimit të energjisë së humbur.
Provë: Procesverbali nr 066928
- Me datë 23.06.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR08HP04027 në shumë prej 1,758.51 €
Provë: Fatura DPR08HP04027 të datës 23.06.2008
- Me datë 19.09.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 02.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit duke u mbështetur në procesverbalet e KEK-ut.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 02.04.2009
- Me datë 16.04.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 09.06.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 09.06.2009
- Me datë 19.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_229_06_09.
Provë: Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_229_06_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Ve

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar